



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, Datë 16.02.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR ZGJERIM TË RRJETIT TË  
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT "VODAFONE ALBANIA"  
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 27 STACIONE BAZË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli Kombëtar i Territorit.

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për zgjerim të rrjetit të komunikimeve elektronike të operatorit "Vodafone Albania", nëpërmjet shtimit të antenave për 27 stacione bazë, me subjekt kërkues "Hellas Service" sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
  - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
  - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave të stacioneve bazë.
3. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njësive të Qeverisjes Vendore.
4. Ngarkohet Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



**ZËVENDËS KRYETARE E KKT**

**EGLANTINA GJERMENI**

**MINISTËRI I ZHVILLIMIT URBAN**



**Znj. MILENA HARITO**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Milena Harito".

**MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE**



**SEKRETARE E KKT**

**ADELINA GRECA**

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Adelina Greca".



**DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT**